



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:020431
Datë: 07.08.2024
Numri i dokumentit: 06027985

Kom.Dh.Shk.II.nr.1216/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit NTSH Marimanga dhe NTSH Besa Cika, me seli në Prishtinë, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, në çështjen përmbartimore, për shkak të borxhit në bazë të dokumentit përmbartimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.626/22 dt. 31.07.2023, më datën 07.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit Komuna e Prishtinës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.626/22 dt. 31.07.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.626/22 dt. 31.07.2023, në piken I të dispozitivit e ka pranuar pjesërisht në tërësi si i bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, ashtu që anulohet pjesërisht Urdhrit Përmbartimor P.nr.310/2020 të datës 18.12.2020, i lejuar nga Përmbartues Privat Fadil I. Hoxha, sa i përket kamatës ligjore në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore dhe shpenzimeve të procedurë përmbartimore. Në piken II të dispozitivit, ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, ashtu që mbetet në fuqi pjesa tjetër e Urdhri Përmbartimor P.nr.310/2020 të datës 18.12.2020 i lejuar nga Përmbartues Privat Fadil I. Hoxha, sa i përket detyrimit kryesor në shumën e përgjithshëm prej 24,031.34 euro, me kamatë ligjore lidhur me këtë pjesë,

shpenzimet të procedurës kontestimore në vlerë prej 787.00 euro si dhe shpenzimeve të procedurës përmbarimore në vlerë prej 468.00 euro.

Ankesë ka paraqitur në afat ligjor debitori, me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa, dhe aktvendimi i atakuar të priset dhe lënda ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, apo aktvendimi i atakuar të ndryshohet dhe urdhrin përmbarimore i përmbaruesit privat P.nr.310/2020 të datës 18.12.2020, ta shfuqizojë dhe ta hedhë propozimin e debitorit.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar kreditori, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e kreditorit, dhe ka propozuar që të refuzohet ankesa e kreditorit si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi aktvendimi i atakuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit NTSH Marimanga dhe NTSH Besa Cika, me seli në Prishtinë, ka lëshuar Urdhër Përmbarimor P.nr.310/2020 të datës 18.12.2020, në bazë të dokumentit përmbarues – Aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.378/17 i datës 21.03.2019, i ndryshuar dhe vërtetuar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Apelit të Kosovës Ae.nr. 187/19 i datës 25.09.2020, me të cilën është detyruar debitori që kreditorit NTSH Marimanga në emër të borxhit t'ia paguaj shumën prej 13,391.69 € dhe kreditorit NTSH Besa Cika, shumën prej 10,639.65 euro, në total pra shumën prej 24,031.34 euro si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në vlerë prej 787.10 euro si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në vlerë prej 468.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga data 23.12.2018 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të urdhëri përmbarimor.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbarimor me arsyetimin se për këtë çështje se ky dokument përmbarimore nuk ka titull ekzekutiv, pasi që nuk janë paraqitur në origjinal apo kopje të vërtetuar. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke theksuar se dokumenti me të cilin është iniciuar procedura përmbarimore është konform ligjit për procedurën përmbarimore dhe vetëm qëllimi i vetëm është shtyrjen e vendimit, andaj propozojmë që të refuzohet urdhëri për lejimin e përmbarimit të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.626/22 dt. 31.07.2023, në piken I të dispozitivit e ka pranuar pjesërisht në tërësi si i bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, ashtu që anulohet pjesërisht Urdhrit Përmbarimor P.nr.310/2020 të datës 18.12.2020, i lejuar nga Përmbarues Privat Fadil I. Hoxha, sa i përket kamatës ligjore në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore dhe shpenzimeve të procedurës përmbarimore. Në piken II të dispozitivit, ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, ashtu që mbetet në fuqi pjesa tjetër e Urdhri Përmbarimor P.nr.310/2020 të datës 18.12.2020 i lejuar nga Përmbarues Privat Fadil I. Hoxha, sa i përket detyrimit kryesor në shumën e përgjithshëm prej 24,031.34 euro, me kamatë ligjore lidhur me këtë pjesë,

shpenzimet të procedurës kontestimore në vlerë prej 787.00 euro si dhe shpenzimeve të procedurës përbarimore në vlerë prej 468.00 euro.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se organi përbarues ka lejuar përbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: "*Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.*" Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përbarimor përkatësisht Aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.378/17 i datës 21.03.2019, i ndryshuar dhe vërtetuar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Apelit të Kosovës Ae.nr. 187/19 i datës 25.09.2020, mbi bazën e të cilit përbaruesi privat ka lejuar përbarimin, dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përbarues sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata vlerëson se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 27 paragrafin 1, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. Poashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.378/17 i datës 21.03.2019, i ndryshuar dhe vërtetuar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Apelit të Kosovës Ae.nr. 187/19 i datës 25.09.2020, mbi bazën e të cilit përbaruesi privat ka lejuar përbarimin, i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 36, paragrafin 1 të LPP-se, sipas të cilit përcaktohet se: "*Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri*", dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: "*Vërtetimin për përbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë*", ngase i njëjti është bërë i plotfuqishëm me datën 25.09.2020, ndërsa i ekzekutueshëm me datën 13.11.2020. Gjykata, ka vlerësuar pretendimet e debitorit i cili ka theksuar se ndaj vendimit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk ka përcaktuar detyrimin e palës debitore mbi shpenzimet e procedurës kontestimore në vlerën e lartë cekur në urdhër, prandaj gjeti se të njëjtat janë pjesërisht i bazuara pasi që, kamata ligjore në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore dhe procedurës përbarimore, pasi që në këtë pjesë, urdhëri për lejimin e përbarimit nuk është në përputhje me dokumentin vërtetuar me Aktgjykimin e përbarimor, sepse Aktgjykimi [III.EK.nr. 378/2017](#) të datës 21.03.2019, pjesërisht i ndryshuar dhe i vërtetuar Gjykatës Apelit të Kosovës Ae.nr. 187/19 i datës 25.09.2020 e njeh kamatën ligjore vetëm sa i përket borxhit kryesorë, andaj gjykata urdhërin përbarimor e shfuqizon pjesërisht vetëm sa i përket pjesën së kamatës së kërkuar për shpenzimet e procedurës kontestimore dhe shpenzimeve të procedurës përbarimore.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përbarimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përbarimore. Kjo gjykate vlerëson se në rastin konkret Vendimit III.EK.nr.378/17 i datës 21.03.2019, i formës së prerë me datën 25.09.2020, ndërsa i ekzekutueshëm me datën 13.11.2020, me të cilën është detyruar debitori që kreditorit NTSH Marimanga në emër të borxhit t’ia paguaj shumën prej 13,391.69 € dhe kreditorit NTSH Besa Cika, shumën prej 10,639.65 euro, në shumën totale prej 24,031.34 euro, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim, i plotëson kushtet për të qene dokument përbarimor me titull ekzekutiv, sepse i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 21 dhe 22 të LPP-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dokumenti mbi të cilin është lejuar përbarimi, Vendimit III.EK.nr.378/17 i datës 21.03.2019, i formës së prerë me datën 25.09.2020, ndërsa i ekzekutueshëm me datën 13.11.2020, përben bazën juridike për caktimin e përbarimit, pasi që paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 21 të Ligjit për Procedurën Përbarimore, në të cilin përcaktohet se “ *Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshme, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*” dhe nenit 22 par.1 pika 1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohen dokumentet përbaruese siç janë “*Vendimi përbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktapajtimi*”. Në rastin konkret Vendimit III.EK.nr.378/17 i datës 21.03.2019, i formës së prerë me datën 25.09.2020, ndërsa i ekzekutueshëm me datën 13.11.2020, i përmban elementet e një vendimi të organit administrativ, dhe se e ka cilësinë e dokumentit përbarues edhe sipas nenit 27, LPP-së, ku përcakton se “*Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”. Po ashtu dokumentit/ Vendimit III.EK.nr.378/17 i datës 21.03.2019, i formës së prerë me datën 25.09.2020, ndërsa i ekzekutueshëm me datën 13.11.2020, nuk i mungon forma e saktë ku së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri, sipas nenit 36 par.1 të LPP-së.

Andaj, Gjykata Komerciale – dhoma e shkallës së dytë vlerëson së gjykata e shkallës së parë drejte ka vendosur kur e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit, me arsyetimin se në bazë të shkresave të lëndës rezulton se vendimi mbi të cilin përbaruesi privat e ka lejuar urdhrin përbarimor të debitorit me Vendimit III.EK.nr.378/17 i datës 21.03.2019, i formës së prerë me datën 25.09.2020, ndërsa i ekzekutueshëm me datën 13.11.2020, paraqet dokument përbarimor në kuptim të dispozitave të LPP-së, për shkak se përmban vulën e ekzekutueshmërisë dhe plotfuqishmërisë, si dhe vendimi mbi bazën e të cilit është nxjerrë urdhri përbarimor i plotëson kushtet në kuptim të nenit 22 par.1 të Ligjit për Procedurën Përbarimor.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të debitorit por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitorë për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon

se pala kreditore ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e mos kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka pranuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe e ka lënë në fuqi urdhrin për përmbarim sa i përket detyrimit në shumën prej 24,031.34 euro të Përmbaruesit Privat, P.nr.310/2020 të datës 18.12.2020.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1216/23 dt.07.08.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami